



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverballi i mbajtur më 29 korrik 2016, në mbledhjen e XXXI-të (tridhjetenjë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç znj.Fatlume Jaha, dhe znj.Kadrije Mulolli të cilat munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht përshëndeti të pranishmit, theksoi, thirrja dhe materiali për këtë mbledhje u është dërguar me kohë, mirëpo të nesërmen pas dërgimit të thirrjes dhe materialit, është paraqitur edhe një pikë shtesë e cila u është dërguar si thirrje duke i'u është bashkëngjitur rendit të propozuar të ditës, përkatësisht është dërguar propozimi i Vendimit për mbështetje financiare Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë. Dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) janë shqyrtuar të gjitha këto pika ku edhe janë rekomanduar që Kuvendi i Komunës t'i shqyrtoj sot, rekomandime të cilat u janë shpërndarë para fillimit të kësaj mbledhje. E hapë debatin nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës së bashku me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Gjithashtu ju njoftoj se janë parashtruar dy kërkesa për mbështetje financiare nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, dhe nga Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, kërkesa me të cilat është kërkuar ndihmë financiare me rastin e rishikimit të buxhetit, mirëpo këto kërkesa kanë ardhur pas miratimit të vendimit për rishikimin e buxhetit. Sipas kërkesave shumë e kërkuara nuk janë të mëdhaja e që sipas Rregullores së subvencioneve, vendosja për shuma të tilla është çështje e Ekzekutivit të Komunës.

Pra ky ishte vetëm një njoftim për ju sepse kërkesat janë parashtruar me vonesë nga ana e 2 Shoqatave të cekura.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe propozim Vendimin për mbështetje financiare Teatrit e Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, dhe konstatimet e rekomanduara në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më 28 korrik 2016.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 29 qershor 2016

Pas votimit, njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit e mbajtur më 29 qershor 2016

3. Raporti financiar për periudhën janar – qershor 2016

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF) e paraqiti fjalën hyrëse.

z.Fidan Rekaliiu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e vlerësojmë raportin financiar për periudhën janar – qershor 2016, të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, dhe mendojmë se është një raport i cili pasqyron të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e Komunës gjatë kësaj periudhe kohore. Ajo çka vlen të ceket nga ky raport është se kemi zvogëlim të shpenzimeve për afro 2 %, dhe kemi një rritje të të hyrave prej 38 % në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2015.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, parafolësi e lavdëroj këtë raport, ndërsa ne vetëm po e paraqesim një gjendje reale e cila është paraqitur në këtë dokument. Edhe pse drejtori i DBF dy vitet e fundit rregullisht e ka sjellë ashtu siç edhe e ka për obligim, unë edhe dje në mbledhjen e KPF-së nuk kam dashur të debatoj me drejtorin e DBF-së edhe pse kjo Drejtori vetëm bënë pagesat e faturave të sjella nga Drejtoritë tjera me të cilat dëshiroj të debatojmë sot. Gjithherë në raporte financiare të shpenzimet e Ekzekutivit të Komunës shqetësimi më i madh është keqpërdorimi i mjeteve nga të hyrat vetanake, mjete të cilat inkasohen dhe menaxhohen nga vetë Komuna dhe të cilat nuk mund të mbesin suficit buxhetor.

Për këtë gjashtëmuor janë 5,500 € shpenzime për mirëmbajtje të automjeteve, ndërsa ne ne jemi në dijeni se vitin e kaluar janë blerë vetura të reja, por tani, duke pas parasysh koston e mirëmbajtjes dhe servisimit të tyre edhe nga raporti i kaluar del se rreth 7,000.00€ janë shpenzuar për ato vetura, dhe për këtë ne do t'i shikojmë faturat përkatëse dhe do të analizojmë çmimin e pjesëve, mirëmbajtjes dhe servisimit të veturave qofshin private qofshin zyrtare. Nuk jam në dijeni se çfarë është ndërhyrë në veturat e reja dhe çfarë mirëmbajtje apo servisi është bërë, por jemi në dijeni se drejtori i Drejtorisë përkatëse ka vënë në shitje disa vetura të vjetruara si pasuri e Komunës, pa pasur vendim të Kuvendit të Komunës e që mendoj se edhe Kryesuesi i Kuvendit është dashur të mos lejoj shitjen e tyre pa pasur vendim të Kuvendit, ku pagesa për ato vetura ka qenë rreth 400 € për një veturë, ndërsa ne kemi shikuar edhe pagesat e intervenimit në ato vetura e që e tejkalojnë koston e shitjes ku ndoshta fatura e mirëmbajtjes së një veture ka qenë 500 € kurse vetura është shitur 400 €, ndërsa tani është bërë ndërhyrje dhe janë shpenzuar 5,500.00 € për vetura të reja gjë për të cilën mendoj se është përgjegjësi edhe e shoferëve dhe mbikëqyrësve të veturave. Çështje tjetër janë edhe shpenzimet për vendime të dhunshme nga Gjykatat që pothuajse vazhdimisht janë duke u përsëritur në të gjitha raportet financiare, dhe sipas ligjit përkatës të Ministrisë së Financave, neni 39.2, ku shuma e shpenzuar si pasojë e këtyre vendimeve arrin shumën 20,000.00 €, gjë për të cilën mendoj se Komuna ka dalë humbëse dhe për këtë ne e kuptojmë se deshëm apo nuk deshëm vendimet e Gjykatave duhet të paguhet por aty përfshihen edhe taksat dhe kamatat e që në përgjithësi e tejkalojnë faturën që është dashur të paguhet me kohë kur operatorët përkatës kanë kryer punën e vet. Gjithashtu problem tjetër është edhe keqpërdorimi i të hyrave vetanake për punëtorë me kontratë mbi vepër ku shuma për këtë periudhë arrin afër 7,000.00 €, gjë e cila është edhe vërejtje publike dhe mediale ku punëtorët mbahen në punë me kontratë mbi vepër nga viti 2010. Unë mendoj se të gjithë qytetarët e kanë

të drejtën e barabartë në kushte të aplikimit qoftë për punësim, për kontratë mbi vepër qoftë diçka tjetër, çështje për të cilën nuk dëshiroj të ndalem në nivel të politikës, mirëpo jemi në dijeni se Kryetari i Komunës e ka bllokuar një vend pune që është drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kurse z.Avni Fetahun e mban edhe pozitën e drejtorit të asaj Drejtorie por edhe pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, kurse ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës kemi bërë thirrje gjithëherë që të emërohet një drejtor i ri profesionist në njërin prej Drejtorive të lartcekura, në rast se dëshirojmë punësim në mënyrë që ai vend pune të hapet, të ketë punësim dhe që ai vend pune të menaxhohet ashtu si duhet, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur që nga emërimi i ish drejtorit z.Vezir Januzi në pozitën e Zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e që ne mendojmë se sado që ka qenë keq menaxhimi i fushës së cekur prapëseprapë ka qenë drejtori adekuat që është marrë me atë çështje, ndërsa drejtori aktual nuk po mundet ta kryen detyrën e tij, e them këtë sepse në Komunën e Podujevës nuk ka zhvillim ekonomik dhe besoj se dëshmitarë të kësaj jemi të gjithë.

Problem tjetër është edhe inkasimi i të hyrave vetanake, ne realisht i krenohemi ngritjes së përqindjes së inkasimit, mirëpo jemi në dijeni sa ka arritë kostoja e borxheve prej pronës publike, gjë për të cilën është në dijeni shumë mirë drejtori z.Abaz Llulaliu. Te shpenzimet e telefonisë mobile, kemi ndoshta 100% shpenzime më të ulta në telefoninë fikse zyrtare ndërsa kemi ngritje në telefoninë mobile, dhe nga kjo del se zyrtarët dhe drejtorët më shumë punojnë jashtë objektit se sa brenda objektit të Komunës, ose mund të heqim dorë nga marrëveshja me operatorin përkatës për telefonata falas mes zyrtarëve dhe të tjerëve dhe po kthehemi me vetë pagesa, e jo vetëm Kryetari, Nënkryetari dhe drejtorët të shpenzojnë një kosto afërsisht 500 – 600 €. Problem tjetër është se Drejtoritë përkatëse nuk kanë ndërmarrë asnjë hapë, e që vlen të ceket se drejtoreshës së Drejtorisë së Inspeksionit në fillim të mandatit të saj në këtë pozitë i kam thënë se asnjëherë për gjashtë muaj nuk do të diskutoj për atë Drejtori, por tani ka kaluar ajo kohë dhe ne tani në pikën vijuese të rendit të ditës kemi disa pyetje për drejtoreshën, cilat veprime janë ndërmarr dhe a ka pasur rekomandim nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë për disa çështje konkrete në funksion të kryerjes së detyrës. Po të ishte krejt në rregull ky dokument, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës pa hezitim do ta votonim, mirëpo me këto gjetje dhe këto pagesa që janë bërë, me këto kode dhe shpenzime të panevojshme ne nuk e mbështesim, pavarësisht a kalon me vota apo jo. Jemi që vendet e punës, mbase janë aq të nevojshëm dhe që Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse kanë paraparë që ata persona të punësohen me kontratë mbi vepër, të hapen konkurset dhe të rekrutohen ata persona, e jo të mbahen me kontratë mbi vepër, sepse nëse ka pagesë, ka kod dhe ka buxhet është dashur të hapet vendi i punës, e jo të mbahen peng vendet përkatëse të punës duke përfshirë edhe mbajtjen e drejtorëve me ushtrues detyre sepse është e pakuptueshme që në vitin 2016 të mbahet peng dikasteri kryesor i zhvillimit ekonomik me vend bosh, pa drejtor, dhe për këtë çështje do të ishte mirë drejtori përkatës i cili mban dy pozita të deklarohet që nuk mund t'i mban dy vende pune në mënyrë që ne si Kuvend me një kërkesë të kërkonim emërimin e një drejtori të Drejtorisë përkatëse, e jo të ndodh që të kryhet mandati dhe të mbahen tri vende pune të bllokuara, e them këtë për arsye se ekziston buxheti dhe kodi në listën e pagave për drejtorin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pastaj mundësia ligjore ekziston që të shpallet vendi i lirë i punës por që nuk shpallet, dhe për këtë mendoj se Kryesuesi i Kuvendit për këtë çështje është dashur të jetë më i zëshmi pasi që vjen nga partia që është në pozitë dhe e drejton Kuvendin e Komunës, mirëpo po veproni me parimin e përkrahjes politike, e jo gjithëpërfshirjes qytetare, dhe kjo është qëndrim i Kryesuesit dhe i Grupit të këshilltarëve të LDK-

së, mirëpo unë mendoj se më këtë janë të pakënaqur të gjithë këshilltarët e Kuvendit dhe qytetarët. Ne si Grupi kemi votuar disa propozime të cilat kanë qenë në interes publik siç ishte ai për caktim të lokacionit për ndërtimin e Palestrës së sporteve, pastaj propozimi për KF "Llapi" ku vlen të përmendet se në atë mbledhje u bë zhurmë rreth përbërjes së komisionit, ndërsa tani ende ai komision nuk është takuar dhe nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimesh, çështje për të cilën mendoj se nëse ai komision nuk bënë konsultime me ndonjë institucion tjetër nuk do të mund të kryej punën e vet asnjëherë për shkak të interferimit të personave jo adekuat në atë komision.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, duke iu referuar parafolesit, theksoi, liria e shprehjes është e drejtë e garantuar dhe secili prej këshilltarëve ka të drejtë ta shpreh mendimin e vet.

z.Bahri Selimi, theksoi, çështja e raporteve financiare pothuajse është bërë gjithherë pasqyrë e njëjtë, me zbritje dhe ngritje të kodeve të ndryshme, mirëpo marrë në përgjithësi është e njëjta, kurse si është dhe si do të duhej të ishte pasqyra e financiare është çështje tjetër. Unë mendoj se paraprakisht për të qenë në dijeni për dinamikën e shpenzimeve të parasë, është dashur që fillimisht të kemi një plan të punës në mënyrë që të analizohet dinamika e investimeve dhe shpenzimeve buxhetore, plan i cili asnjëherë, nga asnjë Drejtori nuk është sjellë në Kuvendin e Komunës gjatë këtij mandati, në mënyrë që ne këshilltarët e Kuvendit sado pak të analizonim raportet financiare dhe vlerësonim dinamikën dhe shpenzimet e Komunës. Në këtë raport përshtypje më ka bërë shuma bukur e madhe prej 5,122.00 € e shpenzuar për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, përderisa ato automjete janë të reja dhe nuk kanë nevojë për ndonjë mirëmbajtje të madhe. Gjithashtu përshtypje më ka bërë edhe shuma e shpenzuar për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve zyrtare gjë për të cilën pyes se si ka mundur të vijë deri tek ky shpenzim kur kemi parasysh se shuma e shpenzuar për regjistrimet është 63 % më lirë, ndërsa në anën tjetër kemi numër më të madh të automjeteve që janë regjistruar. Pra paraqiten dy çështje të kundërta mes vete sepse përderisa shpenzimet për mirëmbajtje do të duhej të ishin më të vogla sepse automjetet janë të reja, kurse shuma për regjistrimin dhe sigurimin e tyre do të duhej të ishte më e madhe duke marrë parasysh numrin më të madh të automjeteve zyrtare. Sa i përket shpenzimeve në kode tjera ekonomike po e përsërisë edhe njëherë se ato janë vetëm shifra.

z.Flakron Gashi, theksoi, raporti financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit tregon se është i ngjashëm dhe tregon se është bërë punë sa për një tremujor të dytë të vitit në bazë të shpenzimeve të bëra. Kjo është një praktikë që vazhdimisht e përcjellë Komunën e Podujevës dhe volumi i punëve gjithherë lihet për fund vit, ndërsa procedurat e prokurimit nuk e pengojnë askënd që projektet të planifikohen më herët, mirëpo kjo ndodh si pasoj e mungesës së një plani dinamik të prokurimit. Nuk dua të shtoj më shumë rreth këtij raporti për arsye se pothuajse të gjitha u than nga kolegët parafoles, dhe për të parë më qartësisht shpenzimet se si janë ndarë gjatë këtij viti do të shqyrtohen edhe raportet tjera periodike të muajve në vijim, mirëpo meqë Kryetari i Komunës nuk është prezent sot në këtë mbledhje unë kam një pyetje për Nënkryetarin e Komunës, dhe atë, a është e lejuar që drejtorët e Drejtorive të Komunës, të cilëve fundja nuk mundet askush t'ju imponoj se ku dëshirojnë të jetojnë, por që me shoferë të Komunës në çdo mëngjes me vutura zyrtare shkojnë i marrin nga Prishtina dhe i sjellin në Podujevë dhe pasdite i dërgojnë në shtëpitë e tyre, çështje për të cilën unë mendoj se është e pasjellshme edhe nga na e etikës politike dhe e përgjegjësisë publike para qytetarëve, si dhe gjithashtu normal që rritet edhe kostoja e shpenzimeve të derivateve dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

z.Hasan Softolli, theksoi, raporti financiar për periudhën gjashtëmujore të vitit i përgatitur dhe i sjellë nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, paraq në mënyrë të detajuar të gjitha transaksionet e bëra për periudhën përkatës. Në këtë dokument vërehet se Ekzekutivi i Komunës në mënyrë të vazhdueshme bënë ndryshime në të gjitha fushat ku në disa pozicione vërehen reduktime të

shpenzimeve dhe në disa pozicione tjera ka ngritje të lehtë të shpenzimeve varësisht nevojave të Komunës. Pozitive vërehet rritja e inkasimit të të hyrave vetanake. Në përgjithësi mund të themi se duke bërë krahasime të shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar pothuajse është i njëjtë, andaj në bazë të shqyrtimeve unë nuk e shoh të arsyeshme që ky raport të shtjellohet edhe më tepër.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF) theksoi, me qëllim të korrektësisë dëshiroj të sqaroj dy pika për të cilat ndoshta shtrohen dilema. Sa i përket çështjes së mirëmbajtjes së veturave zyrtare e që u cek se janë shpenzuar rreth 5,000.00€ e që mund të jetë kosto e një veture të blerë, kostoja e një veture të re që është blerë ka qenë 12,500.00 €, ndërsa Komuna e Podujevës menaxhon me mbi 40 automjete zyrtare, sepse përveç automjeteve që shfrytëzohen nga Administrata Komunës, janë edhe automjetet që shfrytëzohen edhe nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjegjësisht Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Punës Sociale, pastaj janë edhe disa automjete që shfrytëzohen nga Drejtoria e Arsimit. Dua të them se nuk kemi të bëjmë me veturat e blera por kemi të bëjmë me mbi 40 automjete zyrtare, vlen të ceket se edhe veturave të blera në afate të caktuara duhet t'iu bëhet servisim i obliguar sepse janë të reja dhe e kanë afatin e caktuar që duhet të servisohen ku një pjesë e servisimit të tyre është pjesë e kontratës ndërsa ndërrimi i vajrave e të ngjashme nuk janë pjesë e kontratës me rastin e blerjes së veturave. Prandaj e them se krejt kjo mirëmbajtje e vetura është në kuadër të numrit të lartcekur të automjeteve zyrtare.

Po ashtu u cekën edhe shpenzimet nga të hyrat vetanake për punëtorët me kontratë mbi vepër, tani saktësisht nuk jam në dijeni se cilit shënim i referohet këshilltari z.Rafet Llapashtica dhe për këtë ndoshta më sqaron tani, mirëpo nëse fjala është për kodin ku shkruhet, punë me kontratë, ajo ka të bëjë me Komisionin Evropian i cili është në projektin për ndërtimin e objektit për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore në fshatin Sfeqël, ku janë një numër i stafit të të punësuarve nga Komisioni Evropian dhe prej tyre paguhen, mirëpo në raport del si pagesë për punë me kontratë. Nuk e përjashtoj mundësinë që edhe ne kemi të punësuar me kontrata të tilla, por punëtorët në fjalë nuk paguhen nga të hyrat vetanake por nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës.

Pra këto ishin vetëm sa për sqarim që nëse është menduar që ato pagesa bëhen nga të hyrat vetanake, mund të vëreni më tutje në raport se jepet shuma totale që Komisioni Evropian paga punëtor për punë me kontratë.

z.Flakron Gashi, theksoi, në mënyrë indirekte parafolësi drejtori i DBF e japi një përgjigje të cilën shumë herë e kemi kërkuar ne si këshilltarë të Kuvendit, ku për herë të parë bëhet me dije se Komuna e Podujevës ka në pronësi rreth 40 vetura zyrtare. Jemi në dijeni se viteve të kaluara janë shpenzuar afër 100,000.00 € për derivate për vetura, dhe nëse e pjesëtojmë me këtë numër del që një veturë zyrtare brenda vitit shpenzon mbi 2300,00 € ose litra naftë, dhe i bie rreth 250 litra naftë brenda një muaji ose afërsisht 5 rezervuare. Kjo i bie që ka keqpërdorim të derivateve të naftës, madje në të ardhmen do të bëhet publike që ndoshta mbushen edhe veturat private apo derivatet hiqen nga veturat zyrtare.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, unë dëshiroj të përfundoj këtë pikë me një konstatim. Edhe dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë raport gjashtëmuor, është evidente se Drejtoria e Buxhetit dhe Financave të dhënat i ka në kontabilitet por edhe në Departamentin e thesarit në Ministrinë e Financave. Shpenzimet e bëra janë gjendje reale afërsisht të njëjta me raportin e periudhës përkatëse të vitit të kaluar me përjashtim të investimeve kapitale ku në bazë të përvojës time gjithëherë në gjashtëmuorin e parë të vitit është shkallë e ulët e shpenzimeve për shkak të

procedurave të tenderimit dhe kushteve jo të favorshme atmosferike, vlen të ceket se nuk mund të bëhet ekzekutimi i pagesave për kompanitë, pa përfunduar punimet kështu që dinamika e punimeve zhvillohet kryesisht në muajt në vijim, mirëpo kjo të jetë si kërkesë e Kuvendit të Komunës që dinamika e punimeve të përcjellët sipas dinamikës së planifikuar në mënyrë që t'i shmangemi suficitit të mundshëm buxhetor. Andaj e hedh në votim raportin financiar janar – qershor 2016.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 13 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2016.

4. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF) e paraqiti fjalën hyrëse.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerësojmë që Komuna ka bërë veprime në adresimin e rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm dhe ushtron kontrollin në pjesën më të madhe të kontrollit të brendshëm. Është shumë e rëndësishme që Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport si dhe vlen të përsëritet zotimi i Kryetarit të Komunës se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna. Sa i përket pasqyrës vjetore financiare, Auditori ka prezantuar një pamje të drejtë në të gjitha aspektet materiale të pranuar dhe pagesave si dhe buxhetit të realizuar të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe Rregulloren financiare të Ministrisë së Financave për pasqyrat vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Republikën e Kosovës dhe si të tillë ne e vlerësojmë këtë raport të Auditorit të përgjithshëm.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, debati rreth raporteve financiare kryesisht po zhvillohet me drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, mirëpo për raporte të tilla është përgjegjësi e secilit që bënë shpenzime. Ne dy seanca më parë kemi shtruar pyetje drejtorit të Drejtorisë së Administratës se sa punëtorë qëndrojnë me kontratë mbi vepër, përgjigja ka qenë sa më duket 12 punëtorë. Nuk dëshirojmë asnjëri prej nesh që raporti të vie i modifikuar apo i pamodifikuar dhe pastaj të shkoj ndokush në burg, absolutisht ne si subjekt opozitar nuk i gëzohemi të keqes që i ndodh ndokujt pavarësisht gabimeve qofshin ato të qëllimshme apo të paqëllimshme. Nuk e arsyetoj qeverisjen për arsye se ne si Komunë kemi ngecur dhe këtë e them duke qenë në dijeni për zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës dhe gjithashtu jemi në dijeni për strategjinë për zhvillim ekonomik, dhe se a jemi apo nuk jemi të kënaqur edhe ne si këshilltarët e Kuvendit me një pagë mujore rreth 200 € që marrim, ndërsa ne si Kuvend nëse miratojmë vendime të tilla po rrezikojmë rrethin e ngushtë dhe atë të gjerë të qytetarëve të Komunës së Podujevës. Mendoj se shumica prej këshilltarëve të Kuvendit të cilët e bëjnë një punë të drejtë kanë kërkesa brenda familjeve të tyre për punësim dhe për të ardhura personale, përjashtimisht një numri të këshilltarëve që kanë ndoshta kushte më të mira financiare dhe mendoj se aty duhet të fokusohemi ne. Është shumë e paarsyeshme që Drejtoria e Administratës të mban punëtorë me kontratë mbi vepër nga viti 2010, për ne Grupin e këshilltarëve nga radhët e PDK-së shumë pak qon peshë se si Auditori i përgjithshëm e quan këtë raport, të modifikuar apo të pamodifikuar, mirëpo Auditori i përgjithshëm ka thënë se është shkel ligji dhe ka specifikuar ligjin përkatës, kurse subjektet opozitare dhe qytetarët marrin hapa legal sepse atë të drejtë ja jep ligji. Unë shtroj pyetje për drejtorin e Drejtorisë

së Administratës, cili punëtorë, për të cilin ka kaq nevojë Komuna e Podujevës për kontributin e tij, është i punësuar me kontratë mbi vepër nga viti 2010, dhe nëse ai punëtorë plotëson dhe e meriton vendin përkatës të punës përse nuk e hap atë vend pune për ta bërë atë punëtorë me kontratë të rregullt të punës, këtë e them pa pasur qëllime apo dallime politike sepse nuk jam në dijeni se cili është ai punëtor dhe cilit subjekt politik i përket por mbi të gjitha është qytetarë i Komunës së Podujevës, pyetje për të cilën mendoj se nuk ka përgjigje as drejtori i Drejtorisë së Administratës e as Kryetari i Komunës. Ne si këshilltarë të Kuvendit nuk mund të komunikojmë me auditorin në këtë seancë dhe nuk jemi të zgjedhur për këtë çështje, mirëpo jemi të zgjidhur problemin e mirëqenies dhe zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës, por nëse ne merremi me raporte të Auditorit se a është i modifikuar apo jo, dhe duke bërë padi dhe për të dërguar dikë në burg, atëherë na duhet të deklarohejmë dhe të marrim një detyrë tjetër, e jo rolin e kuvendarit. Mandej për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Auditori decidivisht ka thënë se, nuk ka mundur Kuvendi i Komunës apo Ekzekutivi i Komunës të ofroj arsyetim pse janë zgjedhë 30 bletarët më të mirë, cilat kanë qenë kushtet, ku një dokument që ofrohet thuhet në 90% të aplikuesve i kanë plotësuar kushtet, andaj si janë eliminuar të tjerët. Kur komisioni përkatës gjatë shqyrtimit të aplikuesve qoftë për punësim qoftë për donacione mendoj se duhet të jepen arsyet e përzgjedhjes, nëse ka përgjigje drejtori z.Avni Fetahu mundet të na jap pse janë eliminuar rreth 190 bletarë, apo edhe përgjigje për eliminimin e aplikuesve të serrave, pra këto janë pyetje të qytetarëve dhe ne si këshilltarë të Kuvendit nuk kemi përgjigje. Pastaj cila është arsyeja që Drejtoria e Arsimit me rastin e dhënies së bursave për nxënës dhe studentë, nuk e publikon se i kujt është nxënësi apo studenti, në kushte dhe kriteret sigurisht figuron edhe nota mesatare, kurse në raportin e procesit mësimorë kemi një nxënësi i cili ka qenë më i miri në gara por që i njëjti nuk figuron si përfitues i bursës. Pra nuk dihen kushtet dhe kriteret e dhënies së bursave, notat mesatare, emrat e prindërve të tyre etj, e që mendoj se nga kjo del se bursat janë dhënë pa kushte dhe pa kriteret sepse janë eliminuar nxënësit më të mirë, andaj si shkak i mos cilësisë së arsimit kemi vetëm 5 studentë të cilët janë pranuar në fakultetin e mjekësisë. Unë si shef i Grupit të këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK-së në emër të Grupit kërkoj që në seancën e radhës të na sjellën në mënyrë zyrtare neve si këshilltarë, listat e specifikuar të nxënësve dhe studentëve që kanë qenë përfitues të bursave, lista e përfituesve të bletëve dhe lista e përfituesve të serrave, të njëjtave t'iu bashkëngjiten edhe kushtet dhe kriteret përkatëse, si dhe arsyet e Komisioneve përkatëse për eliminimin e aplikuesve dhe përzgjedhjen e përfituesve, absolutisht nuk jemi kundër dhënies së subvencioneve, përkundrazi mendojmë se janë të vogla, por janë keqpërdorur sepse ka pasur mundësi të jenë më të mëdha ngase janë mbi 1 milion euro nga të hyrat vetanake por të cilat po duhet t'i ridestinojmë në kode tjera ekonomike për shkak të borxheve financiare, dhe të jeni të bindur se Ekzekutivi i Komunës është në krizë financiare. Raporti i Auditorit të përgjithshëm nuk e zhvillon Komunën e Podujevës dhe nuk e subvencionon agronomin e Podujevës por është Drejtoria përkatëse ajo e cila e bënë atë, pastaj për të hyrat vetanake, nga të gjitha mostrat që janë marrë nga dhënia e pronave të Komunës në shfrytëzim del se ka borxhe të mëdha, nuk jam në dijeni se drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit a ka marrë ndonjë kërkesë nga drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ) për hapat që duhet të ndërmerren, shembull, për ndërprerjen e kontratës, mbylljen etj. hapa të cilët duhet të ndërmerren nga drejtori i DPKGJ sepse askush nuk i jep të drejtë drejtorit përkatës që të lejoj biznes në prona publike nga viti 2004, 2007, dhe të mos inkasoj mjete nga qiraja, gjendje të cilën mendoj se ne këshilltarët e Kuvendit nuk duhet ta lejojmë ose ndryshe ta merr drejtori i Drejtorisë përkatëse dhe ta shfrytëzon vet pronën publike, vetëm të paguaj kafe këshilltarëve që e votojnë atë. Unë sot kërkoj prej drejtorit të DPKGJ që nga këto 10 mostra sa janë gjithsej, të na

publikoj se cilat janë ato biznese prej të cilave nuk janë inkasuar borxhet, cila është arsyeja ose pengesa që i bëhet drejtorit apo që nuk ndërmerren hapat nga ai, nuk dëshiron drejtori të ndërmarr hapa konkret apo cila është pengesa.

z.Bahri Selimi, theksoi, rreth këtij raporti deri tani pati edhe lëvdata por pati edhe shumë fjalë rreth të gjeturave të Auditorit të përgjithshëm, megjithatë edhe unë kam arsyet e mia pse ky raport nuk është ashtu siç do të duhej të ishte për Komunën e Podujevës.

Përshtypje më bëri mos regjistrimi i të gjitha pasurive të Komunës, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së që nga fillimi i këtij mandati pothuajse gjithherë kemi kërkuar nga drejtori i Drejtorisë përkatëse që të kemi një listë të të gjitha pronave dhe pasurisë komunale, listë e cila nuk na është sjellë asnjëherë, por na është sjellë një listë e cila posedon vetëm emra, biznese dhe pronarë, ndërsa ne kemi kërkuar të dimë se nga kush menaxhohen ato prona, sa inkasohen mjete, a paguhen gjithherë qiratë apo nuk paguhen. Tani Auditori i përgjithshëm e ka bërë të qartë pse ne nuk e kemi një listë apo përse nuk na është plotësuar asnjëherë një kërkesë e tillë neve këshilltarëve të Kuvendit të Komunës. Kjo në një formë del se i zoti i shtëpisë nuk e dinë se sa ka pasuri të vetën, andaj mendoj se këtë është dashtë ta rregulloj Kryetari i Komunës së bashku me Ekzekutivin e Komunës përkatësisht drejtorët e Drejtorive të cilët sipas raportit në fjalë nuk i raportojnë fare me shkrim Kryetarit të Komunës për punën e tyre, por vetëm raporte me gojë. Tatimi në pronë është burimi më i madh i të hyrave vetanake, mirëpo tani del se kjo bëhet vetëm prej pronave të cilat janë të regjistruara, andaj po të ishin të regjistruara të gjitha pronat sigurisht se do të rritej edhe inkasimi nga tatimi në pronë, madje mendoj se po të ishin të gjitha pronat e regjistruara, apo mund të ndodh që janë të regjistruara por shtiren se nuk janë, do të ishin taksapaguesit më të mëdhenj të Komunës, sepse mendoj se ata të cilët nuk i përgjigjen Komunës me pagesë të tatimit janë borxhlinjtë më të mëdhenj të Komunës. Auditori i përgjithshëm në raport ka thënë se Komuna e Podujevës nuk ka strategji të zhvillimit ekonomik, e që i bie se nuk ka pasur të paktën deri sa para tri – katër seancave që e kemi miratuar në këtë Kuvend, andaj si ka mundur të thuhet se në Komunën e Podujevës është duke u bërë një zhvillim ekonomik përderisa nuk ka pasur një strategji të shkruar. Sa i përket punësimeve me kontratë mbi vepër mendoj se të gjitha i ceku parafolësi, mirëpo ne jemi në dijeni se sipas ligjit përkatës, me kontratë mbi vepër ka të drejtë të mbahet një punëtor maksimum gjashtë muaj, kurse në raport thuhet se ka të punësuar me kontratë të tillë qe gjashtë vite, do të thotë se në Komunën e Podujevës ka punëtor me kontratë mbi vepër që nga viti 2010, dhe për një gjë të tillë nuk është dhënë kurrfarë llogarie as nga Kryetari i Komunës, as nga Ekzekutivi i Komunës dhe as nga vetë personi i punësuar. Sa i përket subvencioneve, ne tri – katër seanca me radhë kemi kërkuar që të bëhen publike listat e përfituesve në të gjithë sektorët përkatës, ndërsa asnjëherë në këtë mandat ne si Kuvend nuk kemi pasur lista të përfituesve të subvencioneve, madje për këtë çështje Auditori i përgjithshëm e ka cekur se nuk ka plan të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve për përfitim të subvencioneve, ne deri në një masë jemi në dijeni se kush merr subvencione, mirëpo kur gjërat nuk janë të shkruara nuk i themi dhe nuk paragjykojmë, por sikur të kishim listat sigurisht se do të analizonim dhe do ta dinim se biri apo bija e kujt është përfitues/e e subvencioneve si dhe do të mund të analizonim edhe anën dhe forcën politike të përfituesve, sepse mendojmë se të paktë janë ata persona të cilët mund të jenë përfitues të subvencioneve në bazë të plotësimit të kushteve dhe kriterëve. Pra Auditori këtë e bënë me dije se cila është arsyeja e mos sjelljes në Kuvend të listave të cekura asnjëherë. Raporti përmban edhe çështje tjera ku disa prej tyre veç u përmenden nga parafolësi, mirëpo unë mendoj se ky raport i auditimit të përgjithshëm është shqetësues për Komunën e Podujevës.

z.Flakron Gashi, theksoi, është fakt se asnjë qenie njerëzore nuk është e përkryer në punët e veta dhe në këtë aspekt as ne si Kuvend dhe as Ekzekutivi i Komunës nuk është i përkryer dhe pa gabime, mirëpo do të ishte rregull dhe korrektësi që lëshimet të pranohen dhe jo të përsëriten vazhdimisht për çdo vit sikurse që nxjerr në pah ky raport i Auditorit të përgjithshëm. Gabimet që bëhen nga Komunitat dhe krerët e Komunave në të gjithë vendin është se i kushtojnë vëmendje një raportit se vetëm a është i kualifikuar apo i pakualifikuar, dhe atë me modesti e përdorin që të shfaqësojnë veten nga përgjegjësia që kanë.

Unë dëshiroj të ndalem tek pjesa e sistemit të auditimit të brendshëm, dhe po e citoj atë që thuhet në këtë raport, Njësia e auditorit të brendshëm në Komunën e Podujevës kishte kryer auditimin në këto fusha, tek paraja e imët, menaxhimi i pasurisë, shpenzimet komunale, të hyrat në shëndetësi, procesi i prokurimit, dhe thuhet, ne kemi marrë për testim dosjen e auditimit që kjo njësi e kishte përfunduar për raportin në fushën e prokurimit dhe kemi konstatuar se mungon programi i auditimit dhe mungojnë dëshmitë e gjetjeve që ishin deponuar në dosje, pra po e ricitoj, mungojnë dëshmitë e gjetjeve që ishin deponuar në gjetje, andaj juristët e dinë që mungesa e dëshmive është mungesë e një fakti që mund të mos e provon një shkelje e cila mund të ketë ndodh, e që besoj se ka ndodhur.

Çështje tjetër që është për brengosje dhe që vazhdimisht e ka përcjellë Komunën e Podujevës është mungesa e një plani për menaxhimin e kontratave për mallra dhe shërbime, ne jemi në dijeni shumë mirë që në QKMF ka pasur kontrata të tilla të lidhura kornizë në kohë dyvjeçare, dhe ka ndodhur që kanë munguar elemente dhe pajisje të cilat janë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve të ndryshme për qytetarë, ndërsa po njerëzit e njëjtë të cilët punojnë në ato pika n'kuadër të QKMF-së në Podujevë i kanë udhëzuar klientët që t'i kryejnë shërbimet private, fjala është për рентgenin, dhe faktet do të dalin së shpejti ku sigurisht do të njoftoheni edhe ju nëse nuk jeni në dijeni. Çështje tjetër është që Kryetari i Komunës e ka krijuar një praktikë të varësisë financiare, këtë e them me plotë bindje, po i përfshijë dy palë përfituese, për serra dhe për shoqëri bletësh, kanë aplikuar mbi 400 persona ku 90% prej këtyre dy grupeve i kanë plotësuar kriteret, kurse kanë përfituar vetëm 90 prej tyre, shuma për të dy kategoritë është mbi 246,000.00 €, pra do të thotë se të gjithë i kanë plotësuar kriteret, mirëpo cili është ai kriter shtesë mbi bazën e të cilit janë ndihmuar përfituesit e subvencioneve dhe transfereve, mendoj se ky kriter i fshehur është dëshmi e qartë se zotri Veliu krijon klientel të varur financiare dhe askush nuk mund ta mohoj këtë. Çështja tjetër, përveç që është e rëndësishme që një Komunë të din se sa ka pasuri dhe ta regjistroj atë si të tërën është shumë me rëndësi që edhe atë të dijë ta trajtoj, duke mos dashur të hyjë në detaje fjala është për të metat e paluajtshërive të dhëna me qira, e që edhe kjo është një varësi, ku ndoshta bizneseve në një kohë afatshkurtër do t'iu ndihmoj por kjo nuk është ndihmesë në mënyrë të rregullt sepse do të kalojnë vite edhe ata pronar do të zhyten në borxhe ndaj Komunës dhe do të kenë probleme financiare, pra kjo bëhet qëllimisht me qëllim që të kenë varësi financiare ndaj Kryetarit të Komunës. Gjithashtu është shumë me rëndësi edhe trajtimi i borxheve, mungesa e protokollit me rastin e ardhjes së faturave do të rritë rrezikun e raportimit jo të drejtë të obligimeve, mundësisë së pagesës së dyfishtë apo edhe humbjes së faturave, pra kjo tregon që paraja që qarkullon dhe që nuk mblidhet përmes bankave, është mirë të dihet dhe të hulumtohet se si është duke u trajtuar dhe si është duke rrjedhur. Prandaj konsideroj se nuk është mirë që këtë raport të Auditorit të përgjithshëm ta shohim bardh e zi, por ta shohim ashtu siç është, askush nuk i gëzohet se a është i kualifikuar apo i pakualifikuar ose a do të shkoj ndokush në burg apo jo sepse fundja jemi qytetarë dhe mund të bëjmë gabime në të zgjedhur, mirëpo nuk është mirë dhe nuk është në rregull që për çdo vit të përsëriten çështjet e njëjta ndërsa drejtorët e Drejtorive të thonë se gjithçka është në rregull.

z.Hasan Softolli, theksoi, raporti i Auditorit të përgjithshëm është dokumenti i radhës i cili e pasuron Komunën e Podujevës nga aspekti administrativ krahas dokumentit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe dokumenteve tjera të ngjashme si dhe ky raport i cili e paraqet opinionin më të lartë apo opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes, pasqyron përgjegjshmëri të kryerjes së punëve dhe detyrave në nivel të Komunës si dhe përgjegjshmëri dhe transparencë të plotë në menaxhimin dhe shfrytëzimin e parasë publike të taksapaguesve dhe qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe atyre në nivel vendi. Po ashtu ky lloj i opinionit për Komunën e Podujevës nga ana e Auditorit të përgjithshëm paraqet besueshmëri të qytetarëve në këtë institucion për shpenzimin e drejtë të parasë publike si dhe besueshmëri ndaj donatorëve të cilët shprehin gatishmëri për përkrahje të Komunës, gjithashtu edhe ndaj investitorëve të cilët vendosin komunikim me Komunën dhe palët tjera. Auditimi për Komunën e Podujevës ka përfshirë fusha të ndryshme dhe Drejtori të ndryshme për të cilat në përgjithësi Auditori është i kënaqshëm ku në disa prej fushave Auditori është i kënaqshëm në nivelin maksimal, që do të thotë se janë respektuar në përpikëri ligjet dhe procedurat ligjore ashtu siç parashihi, në disa prej fushave është tërhequr vëmendja për përmirësim të mëtutjeshëm në mënyrë që mos të ketë hapësirë për qëllime të caktuara. Në fushat që i përkasin domenit të raportimit dhe komunikimit në nivel menaxherial, mendoj se po të kishte sistem informativ të integruar më të avancuar, nuk mendoj se do të kishte hapësirë për paraqitje të kësaj natyre, edhe çështjeve tjera, por normalisht edhe implementimi i plotë i këtyre rekomandimeve apo tërheqjes së vëmendjes për çështje të caktuara të cilat janë të ranguara në raport ka edhe kosto për investime në ato natyra, mirëpo është edhe detyrë e nivelit qendror për përmirësim duke bërë investime në avansimin e këtij sistemi, e them këtë për arsye se niveli qendror e ka më të lehtë monitorimin dhe kontrollin e njësive buxhetore. Unë personalisht falënderoj të gjithë punonjësit e Komunës dhe përgjegjësit e Ekzekutivit të Komunës të cilët me përkushtim në përgjegjshmërinë e kryerjes së punëve kanë bërë që Komuna e Podujevës të ketë epitelin e besueshmërisë, e jo të jemi pjesë e portaleve informative ashtu siç ndodh me disa prej institucioneve dhe Komunave tjera të Kosovës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëshiroj të jap një sqarim ose pyetje për parafolësin të cilin e lus të dëgjon me vëmendje, Komuna e Podujevës ka lidhë kontratë me 19.07.2013 në kohën e fushatës, për shfrytëzimin e hapësirave publike apo bilbodeve në qytet, për një vitë operatori përkatës që është një prej kandidatëve të listës zgjedhore të LDK-së konkretisht Sylë Deshishku nga fshati Bellopojë i cili e ka pasë për një vite kontratën e cekur, kur i them disa gjëra në këtë foltore nuk i them me inate politike, mirëpo nëse ne si këshilltarë të Kuvendit apo edhe si qytetarë të Komunës së Podujevës e lavdërojmë apo e mbështesim atë biznesmen i cili për një vit është dashur t'i paguaj Komunës 8736.00 €, ndërsa i njëjti nuk ka bërë asnjë pagesë, unë nuk e di se si mund të lavdërohet ndokush këtu, përkundrazi, ai që e lavdëron këtë raport duhet të ndjehet i injoruar nëse nuk është arrit inkasimi i atyre mjeteve, duke përfshirë këtu edhe Drejtorinë përkatëse.

Pastaj problemi tjetër është se me datën 27.02.2016 e që më konkretisht mund të na njoftoj drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit, se e ka shikuar këtë çështje dhe ka bërë një procesverbal me të cilin ka konstatuar se hapësirat e cekura edhe pas shkëputjes së kontratës në vitin 2015, vazhdon t'i shfrytëzoj personi i njëjtë. Pra ky është një prej rasteve të shfrytëzimit të pasurisë publike dhe mos raportimit dhe mbikëqyrjes së drejtë, dhe meqë kjo nga këshilltari z.Avni Ajeti mu kërkua në formë të pyetjes që e bëri nga vendi, unë e ndjeva për obligim ta them me emër. Andaj konsideroj se ky raport i Auditorit të përgjithshëm nuk paraqet gjendje të mirë për zhvillim si në aspektin ekonomik, bujqësorë, legal etj. sepse mungesa e reklamave për tubime të Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, Komiteteve dhe organeve tjera ka bërë që qytetarët të mos jenë të informuar sa duhet për zhvillime të ndryshme që ndodhin në Komunë, ndërsa më mirë do të

ishte që publikimet të bëhen në ato hapësira pa pagesë nga ana e Komunës, dhe për këtë është në dijeni shumë mirë Nënkryetari i Komunës i cili e ka mbajtur një takim me qytetarë ku pjesëmarrës kanë qenë vetëm 3 qytetarë.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), dhe i autorizuar për ushtrimin e të gjitha kompetencave të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik (DPZHE), theksoi, fillimisht dëshiroj të sqaroj se që nga 08 korrik 2015 jam i emëruar drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe njëkohësisht jam edhe i autorizuar për t'i kryer detyrat e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. Krahës kësaj periudhe kohore me përgjegjësi të plotë e them se i kemi kryer punët dhe detyrat tona në mënyrën më të mirë të mundshme, madje falë Zotit e kemi edhe vullnetin ku edhe ditëve të shtunë po vijmë në Komunë për të punuar sidomos kur po kemi informata nga terreni, siç ishte ajo më e freskëta ku brenda 5 pikave grumbulluese të mjedrave arrihen deri në 100,000.00 € të hyra direkte tek fermerët, dhe kjo mund të përkthehet në rreth 5000 vende të punës brenda ditës, andaj kjo na jep kurajo që të punojmë dhe të angazhohemi sa më shumë që të jetë e mundur, dhe në lidhje me këtë ka raste ku sipas fermerëve brenda ditës mbledhen dhe dërgohen 100 deri në 200 kilogram mjedra, e që të ardhurat e tyre ditore janë sa një pagë mujore e ndonjërit prej nesh këtu. Kështu që këto janë fakte konkrete të cilat ndikojnë në zhvillim ekonomik, andaj nuk qëndrojnë ato që u than gjatë debatit se nuk ka zhvillim ekonomik apo që ka ngecje në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik. Sa i përket çështjes së subvencioneve, dëshiroj të jap arsyetimin tim, po ashtu me përgjegjësi të plotë e them se sikur të vendosnim kritere më rigorozë në thirrjet për aplikim në të gjitha subvencionet e DBPZHR, sigurisht se pastaj do të thuhej se kriteret e vendosura janë të kurdisura apo tendencë për t'i përvetësuar aplikuesit apo gjëra të ngjashme, mirëpo ne kemi vënë atë kritere të thjeshta në mënyrë që t'u jepet mundësia të aplikojnë secili qytetarë që ka interesim, përndryshe po të vendosnim kritere, shembull, certifikata e ndonjë trajnimit të caktuar apo të ngjashme, sigurisht se të gjitha serrat do të duhej t'ju jepnim 2 apo 3 fermerëve të caktuar, mirëpo kemi lënë mundësi që të aplikojnë të gjithë të interesuari, ndërsa gjatë vlerësimit të brendshëm unë ju siguroj se komisioni përkatës vërtetë ka bërë një punë të shkëlqyer, ku përveç kriterëve që kanë qenë për aplikim, komisioni është takuar, dhe me një formularë ka bërë evidentimin e anëtarëve të familjes, numrin e anëtarëve që janë të punësuar në institucione publike, sa është sipërfaqja e tokës, sa është burimi i ujit, sa sipërfaqe ka të mbjella, sa planifikon me mbjellë dhe elemente tjera të nevojshme të bashkëngjitura në raport, andaj nuk qëndron fakti nga ajo që thuhet nga disa diskutues. Unë personalisht nuk kam komunikuar me zyrtarët e Auditorit të përgjithshëm lidhur me këtë çështje, mirëpo të gjithë përfituesit e subvencioneve janë të dalluar nga aplikuesit e përgjithshëm, realisht në raportin e Auditorit të përgjithshëm thuhet se afër 90% e aplikuesve i kanë plotësuar kriteret e vendosura në konkurs, mirëpo komisioni gjatë vizitave në terren dhe gjatë vlerësimit të mëtutjeshëm të aplikimeve ka gjetur elemente të ndryshme se një person ose aplikues dallon nga një tjetër, gjë që edhe ka rezultuar si përfitues i subvencionit përkatës. Në kuadër të të gjitha aplikimeve të deritanishme duke përfshirë edhe vitin e kaluar, ne gjithsej kemi pasur 8 ankesa, ku prej tyre është përfshirë një person që nuk ka qenë përfitues i serrës, andaj e ripërsëris se nuk qëndron fakti se subvencionimi me serra, me shoqëri të bletëve dhe të tjera janë orientuar ashtu siç u potencua nga disa diskutues paraprak.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, do të përpiqem që në pika të shkurtra dhe qartë të jap përgjigje këshilltarit të Kuvendit z.Rafet Llapashtica, i cili gjatë diskutimit lëshon akuza ndaj neve sa i përket dhënies së pronave dhe hapësirave publike në shfrytëzim. Shfrytëzuesit të cilët janë me vite të tëra në lokale të ndryshme, Drejtorja e Buxhetit dhe Financave inkason për çdo muaj borxhet e qirasë edhe pse kemi deklaruar ashtu siç thuhet

në raport se nuk kemi mundur që të inkasojmë të gjitha borxhet ndaj Komunës, inkasime të cilat bëhen në bashkëveprim dhe në koordinim të dy-tri Drejtorive, ku të gjithë borxhlinjtë mbi 5000.00 € do të paditen në Gjykata përmes zyrtarit përkatës dhe kjo do të ndodhë së shpejti ku ndoshta edhe mund të ketë edhe mbyllje të një numri të bizneseve si shkak i mospagesës së borxheve ndaj Komunës. Sa i përket këshilltarit parafolës z.Bahri Selimi i cili na akuzon se nuk kemi regjistër komunal të pronave, pastaj thotë se nuk janë të regjistruara të gjitha pronat, konsideroj se shumica prej neve jemi në dijeni se çdo parcelë e ka numrin personal, është e regjistruar në Zonën kadastrale përkatëse, pastaj ne kemi ofruar regjistrin e pronave komunale në të gjitha Zonat kadastrale që kemi, mandej regjistër zyrtar është regjistri i pronave të paluajtshme në kadastër i cili përmes Agjensionit Kadastral të Kosovës ka kaluar në sistemin informativ të tokave në Republikën e Kosovës dhe i cili së shpejti do të kalojë në Kadastral Map apo Hartat kadastrale ku pastaj me një klikim në Gjeoportalin e Republikës së Kosovës do të mund të shohim secili prej nesh pronat për të cilat jemi të interesuar si në anën tekstuale ashtu edhe në anën grafike, kjo nuk është vetëm meritë e Komunës së Podujevës por është meritë edhe e nivelit qendrorë dhe donatorëve të jashtëm sepse janë bërë investime të shumta në sistemin kadastral në Republikën e Kosovës ku sigurisht se do të cilësohemi si të parët në Ballkan sa i përket sistemit të kadastrit. Kështu që Kuvendit të Komunës ju kemi ofruar një listë të pronave komunale që posedojmë, ndërsa nuk qëndron ajo që u tha se ka prona të cilat nuk janë të regjistruara.

z.Bahri Selimi, theksoi, drejtori parafolës e ceku emrin tim duke thënë se këshilltari Selimi po na akuzon, andaj në qoftë se drejtori përkatës e ka lexuar raportin e Auditorit të përgjithshëm, del që unë nuk po akuzoj por është Auditori ai që akuzon, sepse në raport decidivisht thotë, më datën 25.11.2015 është identifikuar rreziku i mos regjistrimit të të gjitha pasurive që janë në pronësi të Komunës, pra unë vetëm e ceka atë që Auditori i përgjithshëm e ka thënë në raport. Ne tani jemi në dijeni dhe e kemi të qartë se Komuna nuk i ka të regjistruara të gjitha pronat, neve na është ofruar një regjistër i cili përbëhet prej emrave të pronave dhe emrave të pronarëve, mirëpo nuk na është sjellë regjistri se si menaxhohen ato prona dhe a paguhen qiratë dhe tatimet tjera përkatëse. Unë jam anëtar i komisionit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe jemi në dijeni se lokali i fundit që është dhënë me qira, për gjashtë muaj radhazi nuk ka paguar qiranë, ndërsa drejtori e thotë se menaxhimi i pronave është duke u bërë mirë, gjithashtu jemi në dijeni tash e dy vite me faktin se në Memorialin e Heroit Afrim Zhitia, tani e dy vite nuk mund të vazhdohet me punime për shkak se Komuna nuk është në gjendje ta menaxhojë pronën e vet, përderisa atë pronë e kanë uzurpuar fshatarët aty, dhe Komuna nuk është në gjendje që hapësirën e vet publike ta menaxhojë dhe ta procedojë në Kuvendin e Komunës për dhënie në shfrytëzim për zgjerimin e Memorialit të cekur. Pra këto nuk janë akuza por janë çështje reale të cilat vijnë nga raportet e Auditorëve të ndryshëm.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, drejtori z.Avni Fetahu i bëri disa sqarime mirëpo konsideroj se mjedra nuk mund të llogaritet si zhvillim ekonomik për dy mandate me radhë të qeverisjes së Komunës, edhe përkundër asaj që nuk janë mbjellë të gjitha mjedrat me subvencione nga Komuna por ka një pjesë të madhe të fermerëve që investimet i kanë bërë me mjete vetanake si dhe ka të atillë që investimet i kanë bërë me 50 % ose 70 % me participim. Çështja tjetër, pyetje për drejtorin e cekur, sa është përqindja e papunësisë prej viti në vit dhe a ka statistika përkatëse rreth papunësisë të paktën për këtë mandat në mënyrë që të na paraqitni neve si këshilltarë të Kuvendit se sa është ngecja ose zhvillimi ekonomik, dhe për këtë do të ishte mirë të na jepet një përgjigje, nëse nuk mundet drejtori sot, në seancën tjetër të radhës mund të na paraqet të dhënat përkatëse. Po ashtu drejtori e tha se sa i përket subvencioneve të Bujqësisë, nuk janë vendosë kritere për vlerësim, unë personalisht nuk mund të marrë me mend se si një njeri i cili e kalon të paktën

shkollimin e mesëm mund të vlerëson diçka pa kriter, e lëre më për ndonjë njeri i cili ka shkollim superiorë, për këtë çështje drejtori ndoshta nuk është shpreh apo nuk e ke shpreh atë që ka dashtë ta thotë, apo më tregoni si është e mundur të bëhen vlerësime pa pasur kriterë, gjë për të cilën unë ende nuk po e besoj që një drejtor i një Drejtorie ka mund të vlerësoj aplikacione pa pasur kriterë, sepse kjo bie edhe në kundërshtime me daljen e komisionit në terren për shkak se nuk di çka mund të vlerësoj komisioni kur nuk ka pasur kriterë. Unë mendoj se Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik janë tri Drejtori të cilat mund ta rrisin zhvillimin ekonomik, por që të tria këto janë Drejtoritë më të dështuar në Komunën e Podujevës. Ka kontrata nga viti 2006 që shfrytëzohet prona komunale dhe që nuk ka paguar asnjëherë qiranë kurse nuk janë marrë kurrfarë hapash nga ana e Drejtorisë së Inspeksionit, pastaj nga viti 2013 e këndeje janë rreth 77,000.00 € borxhe ndaj Komunës që nuk janë marrë kurrfarë hapash për inkasimin e tyre, ndërsa në anën tjetër kemi dy kërkesa për mjete buxhetore rreth 1700.00 € nga dy Shoqatat e dala nga lufta të cilat ne si Kuvend nuk duhet t'i shikojmë me sy politik, e që nuk jemi në gjendje ne si Kuvend i Komunës t'jua miratojmë ato kërkesa në mënyrë që në festa apo manifestime të ndryshme t'jua mundësojmë pjesëmarrjen anëtarëve të tyre, dhe për çka bëhet kjo, për arsye se rreth 77,000.00 € janë borxhet që shfrytëzuesit e paluajtshmërive të cilët nuk ja vejnë veshin as institucionit, as Inspeksionit e as Shoqatave. Pra kërkoj që kontratat e tilla të shkëputen sa më shpejtë që është e mundur, dhe kërkoj nga Drejtoria e Inspeksionit që të ndërmarr hapin e parë konkret ligjor lidhur me këtë çështje.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime me qëllim që të jemi sa më të saktë për çështjeje që u cekën deri tani nga disa këshilltarë parafoles. Sa i përket çështjes së regjistrimit të pasurisë, unë po besoj se ju jeni referuar çështjes me numër 13 të raportit ku thuhet, mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëria me rregulloret e menaxhimit të pasurive, pra nëse nuk gaboj është kjo çështje për të cilën po diskutojmë sepse duhet të jemi konkret, e gjetura e Auditorit është kështu, sipas nenit 4 të Rregullores për menaxhimin e pasurive, Komuna duhet të posedoj informata se me çfarë pasurie është e ngarkuar dhe sa ka në përdorim stafi i administratës komunale, vazhdoj të lexoj, Komuna në listat e sajë të pasurive posedon të dhëna për pasuri që ngarkohet secila Drejtori e jo të dhëna për zyrtarë, pra do të thotë se kjo çështje është pak më specifike çka Auditori ka gjetur dhe çka thotë që duhet të veprohet. Në këtë rast fjala është për inventarizim që bëhet në çdo fund vit nga një Komision përkatës i cili ka për detyrë të regjistroj të gjithë inventarizimin e Komunës e cila është në posedim të zyrtarëve përkatës, ka qenë një praktikë për të cilën Auditori ka shkruar se pasuria është regjistruar me Zyra, shembull, Zyra nr. 3, e kështu me radhë, ndërsa vërejtja e Auditorit është që kjo pasuri duhet të regjistrohet individualisht në emër të zyrtarëve përkatës të cilët kanë në përdorim pasurinë përkatëse, dhe me të marrë këtë vërejtje, unë dhe drejtori i Drejtorisë së Administratës kemi marrë hapat e parë që të fillohet me përgatitjen e një rregulloreje të brendshme duke u bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave dhe komisioni i cili në këtë vit do të angazhohet për regjistrimin e pasurisë të regjistron pasurinë në Zyra me emër dhe me mbiemër të zyrtarit përkatës i cili e ka në përdorim pasurinë përkatëse. Prandaj unë mora fjalën për të sqaruar dhe specifikuar këtë se çka Auditori ka gjetur dhe çka ka rekomanduar lidhur me këtë pikë, e që jemi në hap të mirë që në raportin e radhës të mos jetë e gjetur e Auditorit. Gjithashtu çështja numër 14 që është në raportin përkatës, protokollimi i faturave, është çështje e cila i takon të kaluarës sepse është duke u aplikuar. Vlen të ceket se Auditori nëse gjen diçka që nuk është në rregull, para se të formulon pikën si e gjetur, fillimisht konsultohet me mua si drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, andaj edhe sqarova çështjen numër 13 sepse është fjala

për inventarin i cili është regjistruar në emër të Zyrës e që duhet të jetë i regjistruar në emër të zyrtarit i cili e ka në përdorim atë, çështje e cila besoj se do të ndodh në këtë vit dhe nuk do të jetë e gjetur në raportin e radhës.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, varësisht se prej cilit kënd shikohen raportet ashtu edhe ndahen opinionet për atë, qoftë nga pozita e cila i sheh me sy optimist, qoftë nga opozita, që me të drejtë sepse është detyrë e opozitës, 'i sheh me sy pak më pesimist dhe më negativ, mirëpo e mira është që raporti në fjalë nuk mund të ndërrohet dhe është ky që është, në fakt mund të ndërrohet ai i vitit 2016 duke i zbatuar rekomandimet e dhëna në këtë raport dhe ne si Komunë do të bëjmë çmos që edhe rekomandimet e mbetura t'i zbatojmë dhe t'i implementojmë në mënyrë që raporti i vitit vijues të jetë edhe më pozitiv. Baza e raportit është opinionin, i pa kualifikuar ose i pa modifikuar, por në këtë pjesë mandej mund të thuhet me të drejtë që mund të bëhen përmirësime. Unë e falënderoj Ekzekutivin e Komunës që gjatë këtij mandati por edhe mandatin paraprak asnjëherë nuk ka ndodhur që të kemi një raport të kualifikuar nga ana e Auditorit të përgjithshëm, gjë që fatkeqësisht ndodh në shumë institucione të Republikës së Kosovës. Opinionet e Auditorit të përgjithshëm për Komunën e Podujevës paraqesin një bazë të mirë që shumë projekte dhe programe të cilat janë realizuar dhe që janë në realizim e sipër lidhen pikërisht me opinionin e Auditorit, Komuna si Komunë nuk mund të participoj në shumë projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm, qoftë Komisioni Evropian, GIZ, USAID, e të tjera, po që se opinionin e Auditorit do të ishte opinion i kualifikuar.

U cekën edhe çështje tjera, përkatësisht rreth shpenzimeve ku në disa kode thuhet sa janë rritur dhe në disa janë zvogëluar, i cekë disa shembuj, shpenzimet e telefonisë mobile janë rritë ndërsa për telefoni fikse janë zvogëluar, kjo ka ndodh sepse kemi hyrë në rreth bashkë me ju, pra përjashtimisht pagesës së taksës së internetit, shumicën e telefonave nëpër shkolla dhe institucione tjera që kanë qenë telefona fiks i kemi ndërprerë. Sa i përket shpenzimeve për automjete, po harrohet ose po injorohet fakti që janë mbi 40 automjete ku prej tyre vetëm 6 janë automjete të reja kurse të gjitha të tjerat janë automjete të falura – donacione dhe ka të atilla që kanë 40 vite që janë prodhuar siç janë automjetet e zjarrfikjes të cilat servisohej, mirëmbahen por edhe mbushen me derivate nga buxheti i Komunës, dhe në total kur del një shumë e shpenzuar e karburanteve për një vit rreth 100,000.00 €, hyjnë edhe karburantet që janë përdorur edhe për gjeneratorë dhe për disa objekte të cilat ngrohen me naftë, pra unë konsideroj se kur merren krejt këto parasysh atëherë vërtetë ne si Komunë kemi bërë kursime të jashtëzakonshme.

Vërtetë më vie mirë që të gjithë këshilltarët, pa dallim prej cilit subjekt politik janë, e jepen kontributin e tyre dhe sigurisht se edhe vërejtjet e juaja do të shërbejnë për neve si Ekzekutiv i Komunës që raportin tjetër në vitin e radhës ta kemi edhe më mirë, dhe këtu do të jetë edhe kontributi juaj gjithsesi sepse unë besoj se të gjithë ju këshilltarët e Kuvendit jeni të interesuar që Komuna e Podujevës të jetë një Komunë e zhvilluar ekonomikisht dhe një Komunë e cila i zbaton dhe respekton rregullat ligjore.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj të gjithë për diskutimet dhe kontributet e tyre, po ashtu falënderoj Nënkryetarin e Komunës për sqarimet dhe për premtimin e bërë që të gjitha rekomandimet e dhëna nga Auditori i përgjithshëm, Ekzekutivi Komunës i ka marrë seriozisht dhe duke shpresuar ndërmarrjen e veprimeve konkrete në mënyrë që në raportet tjera të mos të përsëriten. Raporti i Auditorit të përgjithshëm është detyrim ligjor të paraqitet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, publikohet edhe në faqen zyrtare të Komunës ku kanë qasje të gjithë qytetarët të shikojnë opinionin dhe rekomandimet e bëra nga një institucion i pavarur i cili pavarësinë e ka të garantuar me Kushtetutë, andaj meqë raporti është i pandryshuar dhe nuk parashihet për votim, e përmbyllë këtë pikë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës.

5. Informatë për përfundimin e vitit mësimor 2015 / 2016

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se ka qenë kërkesë e subjekteve politike që janë në opozitë, që brenda vitit të sjellën të paktën dy informata rreth procesit mësimorë, njëra për përfundimin e vitit shkollor tjetra për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit ka përgatitur dhe ka sjellë informatën e cila ju është dërguar me material, t'ju them të drejtën unë e kam lexuar dhe analizuar këtë informatë e cila përmban statistika ashtu siç është gjendja reale, dhe përmban sqarime tjera të nevojshme për këshilltarët e Kuvendit, pra kjo është një informatë ku drejtori përkatës i ka paraqitë të gjitha çështjet, andaj e hapi debatin.

z.Flakron Gashi, theksoi, mendoj se arsimi është pikë e rëndësishme dhe besoj se do ta shfrytëzojmë këtë pikë të rendit të ditës me diskutime dhe debate dhe unë në kronologji po i referohem këtij raporti. Së pari sa i përket suksesit në shkollat e arsimit fillorë është mirë dhe për tu vlerësuar që nota mesatare është e shkëlqyeshme 4.34, mandej te arsimi i ulët i mesëm, klasa V-të deri në klasën e IX-të janë duke e bërë një rënie dhe komplet një notë mesatare del 4.1 e që prap nuk është për tu nënvlerësuar, mirëpo fakti që është pak më shqetësuese është rezultati i testit të arritshmërisë në shkollat fillore në nivelin e përgjithshëm 58.20%, në raport është potencuar se gjatë testimit ka pasur një përkujdesje rigorozë, gjë për të cilën mendoj se do të ishte mirë të jetë sa më shumë rigorozë sepse rezultatet reale na hynë në punë të gjithëve dhe është më mirë, mirëpo unë mendoj se nëse ky rezultat është vetëm pak mbi gjysmën nuk do të duhej të jetë i kënaqur askush dhe as ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës, dhe unë e shfrytëzoj foltoren e kësaj asambleje që t'ju bëjë thirrje të gjithë mësimdhënësve të nivelit fillorë që të shtrëngojnë kriterin sepse kohëve të fundit dihet se është çliruar pak sa dora sa i përket notimit të nxënësve ngase kështu del se në çdo vit po bie niveli i notës mesatare ku nga ajo që është mbi 4 në shkollë fillore, bie në 3 në shkollë të mesme, si dhe nëse nxjerrim një mesatare Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani" është më lartë ndërsa dy shkollat tjera "Fan S. Noli", dhe "Isa Boletini" me rezultate jo të kënaqshme. Gjithashtu është për tu vlerësuar përqindja e testit të maturës dhe sigurisht se do t'i gëzoheshim që ajo përqindje të ishte 100% mirëpo unë edhe njëherë ju bëjë thirrje të gjithë mësimdhënësve të shkollave të mesme që ta forcojnë kriterin dhe mos të bëhen shumë dorëlidhë sepse në qoftë se në shkollë fillore nota mesatare është 4 kurse në shkollë të mesme 3, atëherë cili është rezultati i kuadrove tonë në studimet diplomike në Universitet. Çështja tjetër është tek përmirësimi i infrastrukturës shkollore ku janë cekur disa projekte dhe disa intervenime që duhet të bëhen në disa shkolla, kryesisht pullaze, inventarë e të ngjashme, mirëpo unë mendoj se jemi të vonuar me procedura tenderuese dhe do ti gëzohesha faktit nëse të gjitha këto intervenime do të kryhen para se të filloj vitit i ri shkollor në fillim të muajit shtator, unë dyshoj për këtë dhe në këtë aspekt bëjë thirrje që në raste të caktuara këto procedura tenderuese të zhvillohen më herët e jo siç është praktikë që të filloj mësimi dhe atëherë gjatë mësimit ose në vikende të bëhen edhe intervenimet në objektet shkollore.

Gjithashtu është për tu vlerësuar edhe çështja e faktit tek pjesëmarrja e nxënësve në gara shtetërore dhe dëshiroj t'i uroj të gjitha ekipet dhe të gjithë nxënësit të cilët kanë marrë medalje apo që janë ranguar në mesin e më të mirëve, mirëpo unë e shohë si jo në rregull që nga disa gara, është vetëm një institucion që është kolegji "Mehmet Akif" e që i bie se nxënësit tanë ose nuk kanë marrë fare pjesë në gara tjera në nivel shtetërorë ose në garat e organizuara nga niveli shtetërorë nuk kanë mundur të jenë në mesin e më të mirëve, për këtë kërkoj një sqarim nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit.

Për fund e kam një kërkesë dhe një pyetje shumë specifike, ne jemi në dijeni se është hapur konkursi për pranimin e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve të shkollave, andaj pyetja është, a është hapur konkursi i nevojshëm për të gjitha ato vende, apo ka ndonjë që nuk është hapur e që ka qenë i obliguar sipas ligjeve në fuqi, dhe a do të jetë ky proces transparent dhe a mund të na siguron që në këtë mandat, kësaj radhe nuk do të bëhen lëshime ashtu siç janë bërë vitin e kaluar.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, me të vërtetë suksesi i gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2015/2016 është një sukses shumë i mirë, dhe që vlen të lavdërohet Drejtoria e Arsimit për punët dhe angazhimet ekipore së bashku me drejtorë të shkollave, me mësimdhënës dhe me të gjithë faktorët tjerë të cilët kanë ndikuar në këtë suksese shumë të mirë të nxënësve të shkollave të Komunës së Podujevës çka mua personalisht më bënë të ndjehem mirë si përfaqësues i qytetarëve por edhe si banorë i Komunës së Podujevës.

Vlen të përhëndeten edhe aktivitetet tjera jashtë mësimore të cilat ndikojnë në ngritjen dhe kreativitetin e të rinjve, duke përfshirë edhe përmirësimi i infrastrukturës shkollore, ndërtimi i objekteve shkollore si dhe shpërblimet e ndryshme të nxënësve në gara të ndryshme.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, dëshiroj të japë disa sqarime lidhur me shqetësimin e këshilltarit z.Flakron Gashi. Për hir të korrektësisë në mënyrë që mos të del pastaj që shkollat nuk kanë plan të vlerësimit, e them se planin e vlerësimit e kanë të gjitha shkollat të cilat edhe veprojnë në bazë të atij plani, gjithashtu apelin që këshilltari i cekur e bëri për mësimdhënës është apel me vend, mirëpo besoj se bashkërisht me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë do ta bëjmë edhe më specifik çështjen e vlerësimit të notës, dhe në këtë aspekt jemi duke përgatitur bashkërisht me Ministrinë planet që do të jenë në nivelin e këshillave profesionale. Po ashtu vlen të përmendet se është Udhëzimi Administrativ i cili e përcakton se si do të duhet të vendoset nota nga ana e mësimdhënësve, këtë e them në mënyrë të përgjithshme, por ne pothuajse jemi në dijeni se të gjithë mësimdhënësit nuk i kanë kriteret e njëjta, mirëpo tani do të hyjmë në grupe profesionale ku do të jetë një kriter, shembull, për grupin e mësimdhënësve të Gjuhës Shqipe do të bëhet një plan i vlerësimit duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ ku do të jenë të detyruar të gjithë mësimdhënësit përkatës t'i përmbahen atij vlerësimi, për mësimdhënës të matematikës do të përgatitet plani nga grupi i matematicientëve, pra varësisht lëndës ose profesionit do të bëhen edhe planet përkatëse të vlerësimit dhe jemi në përpjekje që gjithsesi ta fusim në funksion këtë. Sa i përket çështjes së tenderëve, unë nuk dëshiroj të arsyetohem, mirëpo sigurisht jeni në dijeni se në objekte shkollore nuk mund të punohet më herët se në muajt korrik dhe gusht, edhe pse t'ju them të drejtën unë i kam proceduar, sidomos tek pjesa ku kam renovime të kulmeve të shkollave, mirëpo për çështje të konkurrencës është dashtë të përsëritet konkurrimi, dhe që unë kam menduar që tani veç është dashtë të fillohet me punime, ndërsa te çështjet tjera, nëse keni vërejtur tek fushat sportive – rrethojat nuk e besoj se janë vonuar sepse janë çështje të cilat nuk ndikojnë drejtpërdrejt në fillimin e vitit të ri shkollor. Lidhur me konkursin për Drejtor dhe Zëvendësdrejtorë të shkollave, ju sqaroj se konkursi është i hapur, dhe t'ju them të drejtën është Udhëzimi Administrativ i cili në një formë na kushtëzon do të thoja, apo nuk na lejon të veprojmë deri në fund të konkursit, fjala është për konkurse të shkollave të mesme për arsye se deri në fund të viteve 2017 dhe 2018 të gjithë arsimtarët të cilët punojnë në shkollat e mesme, edhe pse janë bachelor, edhe pse janë ndoshta me 240 kredi nuk lejohet t'iu shpallet vendi i punës derisa në vitet 2017 – 2018 t'iu krijohet mundësia që ata të vazhdojnë me master, pra ne jemi paksa të kushtëzuar rreth kësaj çështjeje sepse nuk ka vende të lira të punës, ndërsa për vendet tjera, ato që janë në konkurs janë vende kryesisht të lira, do të thotë ekziston kuadri, por jo i kualifikuar, dhe ai vend konsiderohet si vend i lirë. ndërsa tek shkollat e mesme këtë problem e kemi sikurse në të gjitha Komuna tjera. Pra për fund mund të them se ndoshta kjo

informatë ka mundur të jetë më e specifikuar, por jemi munduar që në vija të trasha t'i përfshijmë të gjitha ato aktivitete të cilat bashkërisht me zyrtarët e Komunës, me shkollat dhe me Ministrinë e cekur do t'i realizojmë.

z.Flakron Gashi, theksoi, drejtori parafoles nuk dha përgjigje në pyetjen rreth përzgjedhjes së Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve të shkollave, ose ka harruar por shpresoj të merr fjalën sërish në mënyrë që të përgjigjet, kurse mandej do të shohim se si do të rrjedh gjithë ky proces. Sa i përket çështjes që drejtori parafoles e ceku rreth profesorëve të cilët janë me bachelor 3 vjeçar dhe të cilëve nuk ka mundur t'iu hapet vendi i punës, ju njoftoj se në atë Udhëzim Administrativ ekziston edhe një kriter tjetër ku thuhet për ata profesorë të cilët kanë mbi tri vite përvojë të punës, ndërsa praktika e viteve të kaluara është se ka pasur profesor të cilët nuk e kanë përmbushur këtë kriter, dhe besoj se drejtori e din shumë mirë se cilët janë ata profesor sepse në vitin e kaluar kanë qarkulluar edhe emrat e tyre nëpër media, pra nuk e kanë përmbushur këtë kriter dhe nuk iu është shpallur fare vendi i punës. Unë kërkoj që në qoftë se ka ndonjë vend pune që nuk është përmbushur ky kriter nga ndonjë profesor, menjëherë të shpallet ai vend pune dhe në bazë të rregullativës ligjore të procedohet më tutje si konkurs i hapur.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj parafolesit për shpjegimet dhe sqarimet e bëra rreth kësaj informate. E falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili me kohë e ka përgatitë dhe e ka sjellë në Kuvend këtë informatë dhe besoj se sigurisht do t'i ketë parasysh edhe këto diskutime nga kjo mbledhje. Meqë për informata nuk parashihet votim, unë e përfundoj këtë pikë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën tjetër.

6. Propozimi i Vendimit për mbështetje financiare Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të gjithë jemi në dijeni se ne si Kuvend i Komunës kemi marrë vendim për themelimin e këtij Teatri. Besoj se materiali – kërkesa përkatëse sqaron të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mjetet buxhetore të propozuara. Gjithashtu në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar për këtë pikë dhe jemi pajtuar të gjithë që propozim vendimi përkatës të rekomandohet në mbledhjen e Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, andaj nëse nuk ka këshilltarë të lajmëruar për diskutim unë e hedh në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Propozimi i Vendimit për mbështetje financiare Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, sipas kërkesës së paraqitur.

7. Të Ndryshme

z.Flakron Gashi, theksoi, për hire të korrektësisë, unë po ndërlidhem me kërkesat e dy Shoqatave për të cilat në fillim të kësaj mbledhjeje u njoftuam nga Kryesuesi i Kuvendit, përkatësisht Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së. Mendoj se do të ishte praktikë e mirë që shkresat t'ju shpërndaheshin shëfave të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit që në hyrje të kësaj seance dhe t'ju jepej më shumë rëndësi atyre kërkesave, mirëpo fundja ato kërkesa t'i adresohen Ekzekutivit të Komunës sepse kërkesat e atyre dy Shoqatave dëshmojnë që qeverisja lokale nuk ka pasur përkujdesje ndaj këtyre kategorive shoqërore, dhe në këtë aspekt unë sugjeroj dhe kërkoj që në të ardhmen e shkurtër Komuna të parasheh një fond linear qoftë simbolik qoftë fond i cili do të mund të përmbush disa

nevoja të tyre, ta ketë periodik për çdo vit dhe jo të nxirremi ne si këshilltarë të Kuvendit në pozita të pa lakmueshme. Gjithashtu shfrytëzoj rastin të bëjë kërkesë Kryetarit të Komunës dhe gjithë Ekzekutivit të Komunës ta kenë parasysh që në të ardhmen, duke qenë në dijeni se edhe objekti i ri i Komunës është duke u ndërtuar, të gjejnë hapësirë që Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, Shoqata e Veteranëve të Luftës dhe Shoqata e Invalidëve të Luftës, ta kenë një zyrë, qoftë të përbashkët qoftë zyra të ndara në objektin e Komunës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë vetëm dëshiroj t'ju njoftoj se me datën 20.07.2016 përmes një kërkesë kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së z.Fahri Balaj, kërkon 1684.00 €, kërkesë e parashtruar pas afatit të rishikimit të buxhetit të Komunës. Gjithashtu është edhe kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së e nënshkruar nga z.Illaz Islami, kërkesë e cila është bërë 06.07.2016 po ashtu e parashtruar pas miratimit të rishikimit të buxhetit. Vlen të ceket se kërkesat e cekura nuk përkojnë me Rregulloren për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria subvencione dhe transfere, mirëpo unë kërkesat në fjalë do t'ia drejtoj Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shqyrtim.

z.Avni Ajeti, theksoi, meqë drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit është prezent, kam një pyetje, si vijon, a është ndërmarr apo pritet të ndërmerret ndonjë hap për ndonjë Festival Kombëtarë i cili do të ishte diçka e mirë për Komunën e Podujevës, e them këtë ngase ne kemi qenë në shumë Festivale të tilla në komuna të ndryshme ku edhe kemi kaluar shumë mirë. Vlen të ceket se shumica e Komunave organizojnë Festivale të tilla.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, pasi nuk pati këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, nënvizoi, fillimisht ju njoftoj se sipas planit të punës së kuvendit muaji gusht është muaj pushimi, andaj nëse nuk paraqitet ndonjë pikë e rëndësishme, nuk do të ketë mbledhje, mirëpo nëse paraqitet nevoja do të thirret mbledhje sepse jemi përfaqësues së qytetarëve dhe e kemi obligim t'iu përgjigjem interesave të tyre.

Pas këtij njoftimi, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 12;05

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-59378
Podujevë,
29 korrik 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**